



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT KORÇË

VENDIM Nr. 20 datë 09.03.2011

**PËR EMËRIMIN E EKSPERTEVE KONTABËL TË AUTORIZUAR TË  
SH.A "UJËSJELLËS KANALIZIME" KORÇË**

Këshilli Bashkiak, në zbatim të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" Neni 135/ç, të Vendimit Nr. 678, datë 03.10.2007 Për një shtesë në Vendimin nr. 271, datë 9.5.1998 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Statutit tip të Shoqërive Anonime, Shtetërore", të Statutit të Sh.A UKKO Neni 25, si dhe të Ligjit Nr.10091, datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" Neni 42, pasi u njoh me kërkesën për emërim eksperti të dërguar me shkresë nga Drejtoria e Sh.A UKKO,

**VENDOSI**

1. Të emërojë, për të kontrolluar dhe çertifikuar llogaritë vjetore 2010 të Sh.A UKKO, si Ekspertë Kontabël të Autorizuar :

1. Shoqërinë "TELO –AUDITING" Sh.p.k
2. Ilda Ekonomi

Shoqëria para fillimit të punës harton me Ekspertët një projekt-marrëveshje për punën që do të kryhet, me përshkrimin e rubrikave të verifikimeve, kontrolleve, raportimeve etj, për përmbushjen e misionit, orët e punës të parashikuara si dhe honorarin gjithsej.

2. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**GJERGJI PENDAVINJI**